

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj kryetare e kolegjit, Fillim Skoro gjyqtarë referues e Have Haliti, anëtare me bashkëpunëtorin profesional Përparim Zeka, si procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarve B.B. dhe S.A. për shkak të veprës penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope, në bashkëkryerje, nga neni 229, par. 2, lidhur me nenin 31 të KPK-së, për të vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë PTH-DKR-PPA nr.499/18 të ushtruar kundër aktgjykimit PKR nr.79/2015, mbrojtësit të akuzuarit B.B. nga Prishtina av. F.K. ushtruar kundër aktgjykimit të dt.04.09.2018 në seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt.27.11.2018 morri këtë:

AKTGJYKIM

Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit av. F.K., ndryshohet aktgjykimi i gjykatës Themelore- DKR në Prishtinë PKR.nr.79/2015, të dt.04.09.2018, sa i përket vendimit mbi dënimin ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarin B.B., për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve dhe e substancave psikotrope nga neni 229 par.2 të KPK-së lidhur me nenin 31 të KPK-së, dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) Euro, e merr si të vërtetuar, si dhe e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve. Dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari detyrohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse të njëjtin nuk e paguan në afatin e caktuar, dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 (njëzet) Euro, do të llogaritet një ditë burgu.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.79/2015 të dt.04.09.2018 i akuzuari B.B., është shpallur fajtor për veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve substancave psikotrope e analoge në bashkëkryerje nga neni 229 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (viti), dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro.

Nëse i akuzuari nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, me pëlqimin e tij gjykata do të zëvendësoj dënimin me gjobë në urdhër për punë në dobi të përgjithshme, e nëse i dënuari nuk e jep pëlqimin gjykata do ti caktoj një ditë burgim për 20Euro të gjobës.

I akuzuari detyrohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa dalin sipas regjistrit të shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50Euro, si dhe 50Euro, për fondin e kompensimit të viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga i akuzuari është konfiskuar substanca narkotike kanabis (marihuanë)Tetrahidrokanabinol (THC), në peshën totale 5.4 gram, e sekuestruar nga Policia e Kosovës e cila është përdore për kryerjen e veprës penale .

I akuzuari S.A. në bazë të nenit 364 par.1 nën par.3 të KPP-së për veprën penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope, në bashkëkryerje, nga neni 229,par .2,lidhur me nenin 31 të KPK-së, lirohet nga akuza dhe shpenzimet gjyqësore bien në barë të mjeteve buxhetore të asaj gjykate.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesë:

-Mbrojtësi i të akuzuarit B.B. av. F.K. për shkak të shkeljeve esenciale, të dispozitave ligjore të KPPK –së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal në demin e të akuzuarit, dhe vendimit të gabuar mbi dënimin, dhe propozon që aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë dhe të Akuzuarin ta liroj nga akuza, apo lenden ta prishë dhe ta kthejë në rigjykim.

-Prokuroria e Apelit, me shkresën e saj PPA/I.nr.499/2018 të dt. 30.10.2018 , duke u sqaruar përkitazi me ankesat e mbrojtësit të akuzuarit B.B. , av. F.K., ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.B. av. F.K. e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Departamenti i Krimeve të rënda në Prishtinë PKR.79/2015 të dt. 04.09.2018 të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, caktoi seancën e kolegjit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, në të cilën morën pjesë i akuzuari B.B. dhe mbrojtësi i tij av. F.K., ka munguar Prokurori i Apelit-DKR në Prishtinë, i cili me shkresën e tij është deklaruar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.B., të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit B.B. av. F.K. , edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, e duke marrë parasysh edhe sqarimin e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.B. av. F.K., është e bazuar

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B., në ankesën e tij pretendon se gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë vlerësimin e drejtë të motiveve të kryerjes së veprës penale, se dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, ka kundërthënë të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e tij, përshkrimi i dispozitivit dhe arsyetimi janë kontradiktor në mesë veti. Mbrojtja pretendon se Gjykatës nuk i lejohet manipulimi me deklaratat e dëshmitareve. Gjykatës nuk i lejohet të mendon në vend të dëshmitareve dhe ndryshon deklaratat e tyre, me të vetmin qëllim që ta arsyeton faktin se B.B. është shpallur fajtorë dhe se është dënuar edhe me burgim në

periudhën kohore prej 1(një) viti edhe me dënim me gjobë ne shumë prej 500(pesëqind) Euro. Nga të gjitha këto konstatime të gjykatës shihet qartë që nuk janë të mbështetura në asnjë provë dhe mbrojtjes i lejohet të konstatohet se kemi të bëjmë me spekulime. Sipas mbrojtjes është shkel ligji penal në dëm të akuzuarit për faktin se i akuzuari nuk është kryes i kësaj veprë penale, nga se nuk e ka ditur se në patikat e dërguara në burg, gjendet edhe narkotiku, dhe ka propozuar që i akuzuari të lirohet nga akuza.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar për shkak të bazës ankimore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale e duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 gjen se aktgjykimi i ankimuar është i qartë, i kuptueshëm, dhe gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme se i akuzuari B.B. është kryes i veprës penale për të cilën është shpallur fajtorë. Këto fakte vërtetohen nga dëshmitë e dëshmitares G.H. e cila vërteton faktin se në burgun e Lipjanit ka qenë në vuajtje të dënimit bashkëshorti i saj, dhe me S.n me taksitë e kishte shkuar gjer në burgun e Lipjanit, dhe S. në cilësinë e taksistit ia kishte dhënë një qese me patika (puma), për t'ia dorëzuar në burgun e Lipjanit për të burgosurin A.K. i cili ka qenë në vuajtje të dënimit, dhe dëshmitarja kesen me patika ja ka dorëzuar gardianit të burgut. Qesja e najlonit pas dorëzimit gardianit të burgut është kontrolluar dhe pas kontrollit të qeses se najlonit ku kanë qene te vendosura patikat sportive janë gjetur dy qese marihuanë me peshë të përgjithshme prej 5.4 gram, e sipas ekspertizës peshë neto pa qese ka rezultuar te jetë ne peshë prej 4.31 gram. Kjo sasi e marihuanës e cila është dashur që ti dorëzohet të dënuarit A.K. i cili ka qenë në vuajtjen e dënimit në qendrën korrektuese në Lipjan. Ky fakt vendimtar mbështetet edhe në ekspertizën e AKF/2013 -0590/2013-500 të dt.11.03.2013 ku ka rezultuar se substanca e cila është gjetur dhe dorëzuar në ekspertizë në dy qese ka pasur neto peshë prej 4.31 gram, e në favor të përfundimit të këtyre se i akuzuari B.B. me qëllim të shitjes në mënyrë të pa autorizuar i ka dërguar nëpërmjet të S.A.t (taksist) i cili me automjetin e tij taksitë e ka vozitur gjer në qendrën korrektuese në Lipjan dëshmitaren G.H. të cilës ia ka dhënë kesen me patika e ku kanë qenë të vendosura edhe dy qese të llojit marihuanë, e cila këto qese të najlonit dëshmitarja G.H. ia dorëzon gardianit të qendrës korrektuese në Lipjan dhe pas kontrollit është përpiluar procesverbal me numër 2011 AH -1435 të dt.15.11.2011 dhe është vërtetuar se qesja në të cilën kanë qene patikat e sportit të vendosura e cila i është dorëzuar gardianit, janë gjetur dy qese me substance marihuanë në peshë neto 4.31 gram, e nga kjo del se i akuzuari B.B. ka qenë në dijeni se në qesen e najlonit ku kanë qene te vendosura patikat, kanë qenë të vendosura edhe dy qese të najlonit me narkotikë të llojit marihuanë, e më qellim që ajo ti dorëzohet të dënuarit A.K., e të cilën qese të najlonit ku kanë qene patikat sportive edhe dy qese të najlonit me substancë narkotike të llojit marihuanë i akuzuari i ka mbajtur në shatoren e tij, dhe të njëjtat ja ka dorëzuar S.A.t – taksist. S.A. si taksist i cili është liruar nga akuza në mungesë të provave, e i cili në cilësinë e taksistit e ka vozitë dëshmitaren G.H. gjer në qendrën edukuese korrektuese në Lipjan, e cila ka shkuar në vizitë të bashkëshorti i saj, dhe dëshmitarit S.A. ia jepe dhënë kesen e najlonit me patikat sportive e të cilat, për t'ia dorëzuar te burgosurit A.K. i cili ka qenë në vuajtje të dënimit dhe dëshmitarja këto këse të najlonit në të cilën kanë qenë të vendosura patika sportive ia ka dorëzuar gardianit të burgut në Lipjan. Pas dorëzimit të qeses se najlonit është bërë kontrolli i saj dhe në qese të najlonit ku kanë qene edhe patikat sportive janë gjetur dy qese të najlonit me substance narkotike të llojit marihuanë me peshë neto prej 4.31 gram e cila ka qenë e dedikuar që ti dorëzohet të dënuarit A.K. Nga kjo rezulton se Gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plotë rreth argumentimit të kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarit dhe nuk ekzistojnë kundërbërje në mes të asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit dhe me provat të cilat nxjerrën në shqyrtimin gjyqësorë si dhe shkresave të lëndës dhe nga kjo rezulton se aktgjykimi nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par . 1.12 e në lidhje me nenin 370 par.1 të KPP-së, e në të cilën pretendon ankesa e mbrojtësit të akuzuarit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe nuk është fare kontestuese se i akuzuari B.B. nëpërmjet G.H., e cila ka shkuar në vizitë të bashkëshorti i sajë i cili ka qenë në vuajtje të dënimit në qendrën korrektuese në Lipjan dhe kësen e najlonit ku kanë qene te vendosura patikat, ia ka dorëzuar gardianit të burgut. Në tërësi është vërtetuar se pas dorëzimit të najlonit ku kanë qenë te vendosura edhe patikat të cilat është dashur ti dorëzohen A.K.t i cili ka qenë në vuajtje të dënimit, pas kontrollit është vërtetuar se janë gjetur dy qese me substance marihuanë në peshë neto prej 4.31 gram, e nga kjo del se i akuzuari B.B. ka qenë në dijeni se në qesen e najlonit ku kanë qene te vendosura patikat, aty kanë qene te vendosura edhe dy qese te najlonit me substancë narkotike marihuanë, destinimi i marihuanës ka qenë që ajo ti dorëzohet të dënuarit A.K. i cili ka qenë në vuajtje të dënimit në qendrën korrektuese në Lipjan. Kjo gjendje faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit se është shkel ligji penal nga neni 385 par.1 të KPP-së, në dëm të akuzuarit B.B., sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit nuk qëndrojnë. Gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar ligjin penal sepse me dt. 15.11.2011 i akuzuari B.B., në shitoren e tij "My Day" ku ka qenë kësja e najlonit dhe ku kanë qene te vendosura edhe patikat bashke me dy qese të llojit marihuanë në neto peshe prej 4.31 gram (pas kryerjes së ekspertizës), dhe ajo qese e najlonit, i u është dorëzuar taksistit S.A. i cili është liruar nga akuza. S.A. si taksist ka vozitë dëshmitaren G.H. gjer në qendrën edukuese korrektuese në Lipjan dhe dëshmitares ja jepe kësen e najlonit ku kanë qene te vendosura patikat sportive dhe dy qese te najlonit me substance narkotike për t'ia dorëzuar të dënuarit A.K., dhe dëshmitarja e ka pranuar kësen e najlonit dhe të njëjtën ja ka dorëzuar gardianit të burgut dhe pas kontrollit të qeses së najlonit ku kanë qenë te vendosura edhe patikat sportive, është vërtetuar se janë gjetur dy qese me substance marihuanë në peshë neto prej 4.31 gram, e të cilat qese me marihuanë kanë qene te dedikuara për të ju dorëzuar A.K.t i cili ka qenë në vuajtje të dënimit, dhe nga kjo del se gjykata drejt ka aplikuar ligjin penal, e cila është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit

Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me vendimin mbi dënimin, e sipas pretendimeve ankimore të paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit, gjen se pretendimet e paraqitura ankimore janë të bazuara, për faktin se dënimi i shqiptuar me gjobë në shumë prej 500(euro)Euro, është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe dënimin e shqiptuar me gjobë Gjykata e Apelit e merr si të vërtetuar, ndërsa sa i përket vendimit mbi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, Gjykata e Apelit e ndryshoj aktgjykimin dhe kjo për arsye se prej kohës se kryerjes së veprës penale e gjer në marrjen e aktgjykimit ka kaluar kohë e gjatë, se mungojnë pasojat e dëmshme, e duke marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë se i akuzuari B.B. është i martuar baba i dy fëmijëve, mbajtës i familjes, se në gjykatë ka pasur sjellje korrekte. Gjykata e Apelit, duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana lehtësuese e ndryshoj aktgjykimin përkitazi me vendimin mbi dënimin me burgim dhe të akuzuarit B.B. ia zbuti dënimin, duke ia shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 7(shtatë)muajve, ndërsa dënimin me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)Euro, e merr si të vërtetuar dhe këto dënime komulative të shqiptuara me gjobë dhe me burgim, janë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, me bindje se dënimi i shqiptuar të akuzuarit, në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPRK-së, preventiva individuale që të parandalojë të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe preventiva e përgjithshme që ti parandalojë edhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Me aprovimin a ankesës të mbrojtësit të akuzuarit B.B., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, u deshtë të ndryshohet dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 403 par.1 të KPP-së.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.525/2018, me dt.27.11.2018

Procesmbajtës,

Përparim Zeka

Anëtarët e kolegjit,

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetari i kolegjit,

Tonka Berishaj